

URDHËR
Nr. 202, datë 18.11.2025

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS PËR NËNSHKRIMIN E CERTIFIKATAVE
TË KATEGORIZIMIT TË STRUKTURAVE AKOMODUESE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 8, të urdhrit nr. 267, datë 24.7.2019, “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për nënshkrimin e certifikatës së kategorizimit të strukturës akomoduese, të subjekteve të certifikuara nga Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike, te znj. Llambriola Misto, Sekretar i Përgjithshëm.
2. Ngarkohet znj. Llambriola Misto, Sekretar i Përgjithshëm, për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT**
Blendi Gonxhja